

# Masa urgjente dhe të jashtëzakonshme për të ndihmuar në pagesën e qirasë pas urgjencës epidemiologjike Covid-19

Njoftojmë qytetarët që pas vendimit të dirigjentit nr. 262 të datës 22/04/2020 - në bazë të vendimit të Këshillit të Rajonit Toskana nr. 442 të datës 31/03/2020, dhe të vendimit të Këshillit Komunal nr. 65 të datës 21/04/2020- u miratua Njoftimi publik për marrjen e masave urgjente dhe të jashtëzakonshme për të përballuar pagesën e qirasë pas urgjencës epidemiologjike Covid-19.

Ky Njoftim do të jetë i hapur nga ora 12,00 i datës 28/04/2020 deri në orën 12,00 të datës 18/05/2020, për të gjithë punëtorët si të punësuar apo të vetëpunësuar, që kanë mbetur pa punë, i është ulur volumi i punës, pezulluar apo mbyllur plotësisht aktiviteti, që nga data 31/01/2020, dita e shpalljes të urgjencës epidemiologjike Covid- 19.

Kjo ndihmë do të jepet deri sa të mbarojnë fondet e vëna në dispozicion, dhe përfituesit e këtij Njoftimi mund të paraqesin një kërkesë të re edhe për Njoftimin e zakonshëm për Kontributin e qirasë për vitin 2020 (Bando contributo affitto 2020). Shuma e dhënë për këtë Njoftim, duke qënë së është parashikuar si masë urgjente dhe e jashtëzakonshme, do të ulet nga shumata e rimbursimit që mund të përfitohet nga Njoftimi i Kontributit për qeranë të vitit 2020.

[Njoftimi i plotë](#)

## Kushtet për të aplikuar

**Mund të marin pjesë në këtë Njoftim ata persona që në datën e shpalljes plotësojnë këto kushte:**

- Të jenë qytetarë italianë apo të një shteti tjetër të BE-s, në rastin e qytetarëve që nuk bëjnë pjesë në BE, të jenë me leje qëndrimi të vlefshme;
- Të jenë rezidentë në Komunën e Campi Bisenzio;
- Të jenë titullarë të një kontrate shtëpie me qira ku jetojnë dhe që është e regjistruar rregullisht si banesë;
- Të kenë çertifikatë ISE (Çertifikatë e gjëndjes ekonomike) me vlerë ekonomike deri më 28.684,36 € e llogaritur në bazë të DPCM 5 dhjetor 2013 n.159 dhe modifikimeve pasuese; në rast se aplikuesi nuk e ka këtë çertifikatë të vlefshme, mund të paraqesë DSU sipas normave ligjore në fuqi, duke vënë në aplikim numrin e protokollit të praktikës, duke vetëdeklaruar kështu që vlera e çertifikatës personale ISE nuk është më e lartë se shumata prej 28.684,36 €.
- Të kenë pësuar një ulje drastike të të ardhurave familjare jo më pak se 30 % (tridhjetë për qind) për shkak të emergjencës epidemiologjike Covid-19, në krahasim me rrogat mujore të marra në vitin 2019. Kjo ulje mund t'i bazohet të ardhurave nga puna si i punësuar me kontratë pa afat (ulje në orë pune, apo i regjistruar për pagesën e papunësisë (cassa integrazione) etj) si i vetëpunësuar (veçanërisht për kategoritë ATECO ku puna i është mbyllur sipas vendimit të qeverisë), apo i punësuar me çfarëdolloj kontrate, me afat të shkurtër.

## Kush nuk mund të aplikojë

a) Ai/ajo që ka të drejtë pronësie, të uzufuktit apo të përdorimit të një banese e cila është një akomodim mëse i përshtatshëm për nevojat familjare dhe e vendosur në distancë të

barabartë apo jo më shumë se 50 km larg nga Komuna e Campi Bisenzio, përveç rastit kur, një nga pronësitë e patur në zotërim nga familja e aplikuesit hyn tek disa kategorit të tjera si më poshtë:

- kur bashkëshorti/ bashëshortja janë ndarë apo divorcuar ligjërisht sipas një vendimi të gjykatës, dhe nuk ka disponibilitet të shtëpisë martesore ku është pronar;

- të ketë titullin e pronësisë reale të pjesës së tij/saj, për të cilën është i/e dokumentuar padisponueshmëria e tij/saj.

b) të gjithë ata/ato që kanë përfituar nga kontributi i dhënë për qiranë sipas Njoftimit GiovaniSi për autonominë e çifteve të reja, për vitin 2020;

c) të gjithë ata/ato që janë titullar të një banese popullore.

## Si mund të aplikohet

Aplikimi bëhet vetën online në faqen e internetit "[FIDO](#)" brenda orës 12,00 të ditës 18/05/2020.

Nëse nuk keni një kompjuter personal për të dërguar aplikimin online në faqen "[FIDO](#)", komuna vë në dispozicion - vetëm kumpjuterin që ndodhet fizikisht në zyrën [Sportello Polifunzionale](#) pa asistencë - duke marrë përpara një **takim** me to.

Kujtojmë gjithashtu që, për të përdorur faqen e internetit "[FIDO](#)" është e nevojshme që **karta e shëndetësisë të jetë e aktivizuar me kodin personal** ose në alternativë të keni kredencialet S.P.I.D.

## Dokumentacioni i nevojshëm

Aplikimit duhet t'i bashkangjiten me doemos këto dokumenta në formatit: pdf, jpg, tiff dhe me madhësi maksimale jo më shumë se 5 megabyte, në rast të kundërt pezullim nga aplikimi:

a) kopje të kontratës së qerasë, e regjistruar rregullisht, të shtëpisë në të cilën aplikuesi rezulton në gjendjen civile;

b) dokumentacioni që vërteton uljen e të ardhurave ekonomike në lidhje me punën duke filluar nga data 31 janar 2020;

c) leje qëndrimi të vlefshme për qytetarë që nuk bëjnë pjesë në BE

Në rast se kërkohet prioritet sipas udhëzimeve në Njoftim është i nevojshëm që të bashkangjitet çertifikata e invaliditetit në ose mbi 67% dhe /ose çertifikata e handicap sipas ligjit 104/1992.

## Si do të jepet ky kontribut

Brenda 30 ditëve nga data e mbylljes së aplikimit do të publikohet në faqen e internetit të Komunës (Albo pretorio) për 10 (dhjetë) ditë një listë e përkohshme e aplikimeve të pranuar dhe jo. Brenda këtyre 10 ditëve mund të prezantohen vërejtje apo kundërshtime ndaj kësaj liste nëpërmjet një formulari online nga faqja F.I.D.O. Në momenti që mbyllet afati i shqyrtimit të aplikimeve pas kësaj periudhe vërejtjesh, do të publikohet po në faqen e internetit të Komunës (Albo pretorio) lista përfundimtare e përfituesve dhe jopërfituesve.

## Bazat ligjore

L. 431/98;

Vendim i Këshillit Rajonal i Toskanës (Deliberazione della Giunta regionale toscana) n. 442 datë 31/03/2020;

Vendim i Këshillit Komunal (Deliberazione della Giunta municipale) n. 65 datë 21/04/2020;

Vendim i Dirigjentit Sektori II (Determinazione dirigenziale del II Settore) n. 262 datë 22/04/2020.

Për më shumë informacione apo për të patur asistencë telefonike në plotësimin e aplikimit online në faqen "**FIDO**" mund të kontaktoni Zyrën për Banesat (Ufficio casa) në këto numëra telefoni: 055/8959301 - 055/8959313  
apo e-mail: [serv.soc@comune.campi-bisenzio.fi.it](mailto:serv.soc@comune.campi-bisenzio.fi.it)

Sportello Accoglienza cittadini stranieri  
Zyrë pritjeje për qytetarët e huaj:  
Villa Montalvo, Rr. di Limite 15 - Campi Bisenzio  
Orari i hapjes Vetëm për telefon: 055 8959302  
të martë 9.00 me 13.00;  
të mërkurë 9.00 me 13.00;  
të enjte 15.30 me 18.00.  
e- mail: [accoglienza@comune.campi-bisenzio.fi.it](mailto:accoglienza@comune.campi-bisenzio.fi.it)